



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Durrës më 27.09.2021

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimit

Në mbështetje të nenit 18, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak Durrës përpara shqyrtimit dhe miratimit të disa akteve zhvillon konsultime.

Me dorëzimin pranë Sekretares së Këshillit Bashkiak të Projekt-Vendimit dhe Relacionit **“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB 104, DATË 31.08.2021 “PËR NJË SHTESË NË VKB NR.127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME MIRATIMIN E TARIFËS SË UJIT PËR UJITJE”**, të propozuar nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë Durrës, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak ka nisur procesin e Konsultimit Publik.

Në kuadër të këtij procesi, Këshilli Bashkiak publikon këtë projekt-vendim, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.

Për këtë qëllim, mirëpresim çdo koment dhe sugjerim Tuajin, mbi këtë projekt-vendim, të cilat duhet të dërgohen në adresën e e-mail : keshillidurres@gmail.com, brenda 20 ditëve nga publikimi në faqe.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Dorina Milja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKT VENDIM

NR____, DATË__/__/2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB 104, DATË 31.08.2021 “PËR NJË SHTESË NË VKB NR.127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME MIRATIMIN E TARIFËS SË UJIT PËR UJITJE

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr.24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” , VKM-së nr.993, datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkuftare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Ndërmarrja “Rruga”, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e një ndryshimi në VKB-në nr.104, datë 31.08.2021 “Për një shtesë në VKB-në nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, në lidhje me tarifën e ujit për ujitje, si më poshtë vijon:

TARIFA E UJIT PËR UJITJE

Nr.	Kategoria	Njësia
	Tarifë e ujit për ujitje	510 lekë/dynym/nr.ujitje

2. Miratimin e një shtese në VKB-në nr.104, datë 31.08.2021 “Për një shtesë në VKB-në nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, në lidhje me tarifën e mirëmbajtjes së infrastrukturës, si më poshtë vijon:

Nr.	Kategoria	Njësia
	Tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës	0.0557 lekë

3. Miratimin e riformatimit të Tabelës nr.42, si pjesë përbërëse e Vendimit nr.127, datë 14.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” i ndryshuar, si më poshtë :

TABELA NR. 42

TARIFA E UJIT PËR UJITJE DHE TARIFA E MIRËMBAJTES SË INFRASTRUKTURËS

Nr.	Kategoria	Njësia
1.	Tarifë e ujit për ujitje	510 lekë dynymi për nr.ujitje
2.	Tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës	0.0557 lekë

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Ndërmarrja Rruga.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, ”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

**DREJTORIA E TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE**

NDËRMARRJA “RRUGA”

ZËVENDËSKRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
NDËRMARRJA RRUGA

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____/____/ 2021

RELACION

Për

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VKB NR.104, DATË 31.08.2021 “PËR NJË SHITESË NË VKB NR. 127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME MIRATIMIN E TARIFËS SË UJIT PËR UJITJE”

Drejtuar : **KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS**

Baza Ligjore : Në zbatim të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligjit nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” , VKM-së nr.993, datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre” dhe Vendimit Këshillit Bashkiak Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021”, Ju parashtrajmë si më poshtë :

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak me Vendimin nr.104, datë 31.08.2021 miratoi tarifën e ujit për ujitje sipas tabelës përkatëse konkretisht : 510 lekë/dynym/m³. Kjo përllogaritje u bë për shkak se u mendua se fermerët që do të përdornin ujin do të kishin sahat dhe matja do të bëhej me m³. Duke qënë se Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri, u konstatua se asnjë fermer në tokat e tij nuk ka sahat. Gjithashtu në nenin 18, parashikohet se tarifa e shërbimit të ujit mund të llogaritet ;

- sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve
- ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje
- apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.

Nisur nga sa më lart, në mënyrë që kjo tarifë të vilet, por dhe të përshtatet me situatën aktuale të fermerëve të ndryshojë mënyra e përllogaritjes nga 510 lekë/dynym/m³ në 510 lekë/dynym/nr.ujitje. Theksojmë se tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi, pra 510 lekë nuk ndryshon.

Mënyra e përllogaritjes së kësaj tarife sqarohet si më poshtë vijon:

Ndërmarrja Rruga, Bashkia Durrës sipas legjislacionit përkatës, ka marrë në administrim sistemin e ujitjes dhe kullimit, rezervuarët dhe Hidrovorin e Porto Romanos. Rezervuarët janë ujëmbledhës të cilët mbledhin ujin e kodrinave përreth, por edhe për ujitje.

Rezervuarët mbikqyren nga punonjës të Sektorit të Shërbimit të Rrjetit Ujor, (rojtarë uji). Fermerët të cilët shfaqin interes për ujitje kontaktojnë me rojtarin e ujit dhe afishohet një listë në qendër të fshatit, ku lajmërohen për ditën, orën dhe sasinë në m³/ujë që do konsumojë çdo fermer. Rezervuarët që vadisin aktualisht dhe sipërfaqia e shprehur në (dy) e tokave bujqësore që vaditen paraqiten si në tabelën më poshtë:

NR	Emërtimi	m³/ujë aktualisht	Dynym që vaditen	Fshatrat që vaditen nga këto rezervuarë
1	Bozaxhie	120.000	2	Bozaxhie, Rromanat
2	Rromanat	30.000	3	Rromanat
3	Manskuri e Vogël	120.000	9	Manskuri
4	Memaj	30.000	15	Memaj
5	Arapaj	35.000	15	Arapaj
6	Radë 1	100.000	200	Radë, Kameronas
7	Radë 2	70.000	70	Radë
8	Borç	2.000.000	2500	Borç, Radë, Katund i Ri, Sukth, Kameronas

9	Topana	2.300.000	750	Rrotull, Fushë Draç, Shkafane, Hamallaj fshat dhe fermë
10	Tarin	7.800.000	2500	Shkallë, Armathë, Hamallaj, Rrushkull, Kullë, Vadardhë, Shkafane,, Manëz minjerë
Shuma		12.605.000 m³/ujë	6.064 dynym	

Mbështetur në Ligjin nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” si dhe VKM-së nr.993, datë 9.12.2020 “Për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkuftare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre” Ndërrmarja Rruga ka bërë përlllogaritjen e tarifës së ujit për vaditje sa më poshtë;

Duke u mbështetur në nenin 18 “Tarifa e shërbimit të ujitjes”, të Ligjit Nr.24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe te kullimit” :

1. Bashkia vendos një tarifë shërbimi për çdo shpërndarje të ujit për ujitje, në bazë të kërkesës së çdo fermeri.
2. Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve ose vëllimit të ujit të përdorur për çdo ujitje apo kohëzgjatjes së ujitjes dhe çmimit për njësi kohe.
3. Tarifa e shërbimit të ujitjes për njësi përlllogaritet duke iu referuar shpenzimeve për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe të shpërndarjes së ujit për ujitje, përfshirë çdo shpenzim të bërë për furnizimin e një rezerve të tillë ujore.

Tabela e përlllogaritjes së tarifës së ujit/ha:

- Sasia aktuale e gjendjes se ujit të rezervuarëve është 12,605,000 m³.
- Kosto shpenzuese (Punonjësit), 3(punonjës)*39,500(pagë në muaj) = 118,500 (lekë në muaj)*12muaj =1,422,000 lekë ne vit.
- Kosto shpenzuese (shërbime për rezervuarët : blerje vajra, graso, alkol, naftë, filtër vaji etj.) është 1,795,936 lekë.
- Humbje sasi ujë + nivel dheu në fund të rezervuarëve është 50%.

Llogaritje tarife

- Sasia aktuale e ujit në rezervuarë e shprehur në m³ zbresim % në të cilën uji na humbet gjatë rrugës deri në destinacion dhe si përfundim marrim sasinë e ujit 6,302,500m³/ujë.
(12,605,000 m³/ujë - 50 % = 6,302,500 m³/ujë)
- Kjo sasi uji në m³ pjestohen me sipërfaqen e shprehur në ha dhe përfitojmë 630ha që ujitën.
(6,302,500 m³ / 10 000 m³/ha = 630 ha)

- Mbledhim koston shpenzuese (3punonjës) me kosto shpenzuese (vaj, filtra graso, alkol, naftë etj) duke përfituar lekë. Këto lekë pjestohen me 630ha duke përfituar 5100 lekë për ha. (3,217,936 lekë / 630 ha = 5 100 lekë/ha)
- 5100lekë/ha për t'i kthyer në njësinë matëse dynym, pjestohet me 10dynym. (5,100 lekë /ha /10 dynym = 510 lekë/dynym për nr.ujitje)
- Si rezultat i kësaj përlllogaritje nxjerrim tarifën 510lek/dynym për nr.ujitje.

Të ardhurat e parashtruara nga vjelja e kësaj tarife:

6.064 dynym x 510 lekë/dynym = 3.092.640 Lekë

Pra llogaritja është bërë sipas pikës 2, fragmenti i parë i fjalisë, të nenit 18 “Tarifa e shërbimit të ujitjes” të Ligjit nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe te kullimit “Tarifa e shërbimit të ujitjes llogaritet sipas sipërfaqes së ujitur dhe numrit të ujitjeve”, pasi siç e sqaruam dhe më sipër fermerët nuk kanë sahat, kohëzgjatja e ujitjes s’mund të matet pasi lloje të ndryshme kulturash kërkojnë kohëzgjatje të ndryshme dhe çmimi për njësi kohe matet pas këtyre të mësipërme që siç sqaruam s’mund t’i masim dot.

Gjithashtu kërkojmë nga ana juaj të miratoni edhe tarifën e mirëmbajtjes, një detyrim ligjor ky i parashikuar në nenin 17 “Tarifa vjetore e mirëmbajtjes së infrastrukturës”, të Ligjit Nr.24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe te kullimit” ku përcaktohet se:

1. Bashkia mbledh tarifën vjetore të mirëmbajtjes për çdo sipërfaqe toke, brenda zonës së saj të shërbimit të ujitjes. Afati i pagesës së kësaj tarife është brenda datës 31 janar të çdo viti.
2. Tarifa vjetore e mirëmbajtjes i njoftohet, me shkrim, zotëruesit të tokës dhe përlllogaritet duke iu referuar madhësisë së sipërfaqes së saj, në përpjestim me madhësinë e përgjithshme të zonës së shërbimit të ujitjes.
3. Kjo tarifë përfshin shpenzimet e mirëmbajtjes vjetore të sistemit të ujitjes, shpenzimet për përgatitjen eë këtij sistemi për stinën e ardhshme të ujitjes dhe koston e pastrimit të kanaleve kulluese.

Mënyra e përlllogaritjes së tarifës së mirëmbajtjes së infrastrukturës sqarohet si më poshtë :

- Madhësia e sipërfaqes është 6064 dynym.
- Madhësia e përgjithshme është 108750 dynym.
- Përpjestojmë madhësinë e sipërfaqes që fermeri kërkon të ujitet 6064 dynym me madhësinë e përgjithshme të projektuar 108750 dynym.

Pra tarifa e mirëmbajtjes së infrastrukturës është 6064 dynym/108750 dynym = 0.0557 lekë.

Referuar sqarimeve të relacionit lutemi të merrni në konsideratë dhe të miratoni :

1. Ndryshimin e tarifës së ujit për ujitje nga 510 lekë/dynymi për m³ miratuar me VKB nr.104, datë 31.08.2021 në tarifë për ujitje 510 lekë dynym për nr.ujitje.
2. Miratimin e tarifës së mirëmbajtjes së infrastrukturës 0.0557 lekë.

Pra Tabela nr.42 ishte :

**TABELA NR. 42
TARIFA E UJIIT PËR UJITJE**

Nr.	Kategoria	Njësia
	Tarifë e ujit për ujitje	510 lekë dynymi për m ³

Bëhet

TABELA NR. 42

TARIFA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURËS DHE TARIFA E UJIIT PËR UJITJE

Nr.	Kategoria	Njësia
1.	Tarifë e ujit për ujitje	510 lekë dynymi për nr.ujitje
2.	Tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës	0.0557 lekë

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, Ju ftojme të miratoni tarifat e sipërcituara.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

NDËRMARRJA “RRUGA”

DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE